KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1053 Nr. i faq/Br.str/No.pg 202
Data/Datum/Date 2 / 8 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

LISTA E VENDIMEVE TE MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

**MUAJI KORRIK 2023**

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës | NRP-02-936-2023 |
| 2 | Vendim | NRP-02-940-2023 |
| 3 | Vendim-miratohet kërkesa e Organizatës Kmunale të Pensionisteve dhe Invalidëve të punës në Rahovec | NRP-02-941-2023 |
| 4 | Vendim për caktimin e komisionit professional për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshëri, erërat e forta dhe vershlmet e shiut me datë 1 korrik 2023 | NRP-02-942-2023 |
| 5 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë | NRP-02-944-2023 |
| 6 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të project-propozimeve nga projekti ReLOaD2 | NRP-02-945-2023 |
| 7 | Vendim për Qasje në Dokumente publike-INPO | NRP-02-950-2023 |
| 8 | Vendim për caktimin e Shtabit komunal për korrje-shirje për vitin 2023 | NRP-02-951-2023 |
| 9 | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për manifestimet e Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës". | NRP-02-956-2023 |
| 10 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/2125, i datës 18.5.20222 | NRP-02-962-2023 |
| 11 | Vendim | NRP-02-969-2023 |
| 12 | Vendim | NRP-02-970-2023 |
| 13 | Vendim për caktimin e komisjonit për mbikëqyrjen e kontratave | NRP-02-974-2023 |
| 14 | Vendim për dhënien e pushimit nga puna, pa pagesë | NRP-02-975-2023 |
| 15 | Vendim për caktimin e komisionit për rivlerësimn e ofertave | NRP-02-984-2023 |
| 16 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-985-2023 |
| 17 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-991-2023 |
| 18 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-1001-2023 |
| 19 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-1003-2023 |
| 20 | Vendim per nderrimin e pozicioneve ne kontratën me titull Ndertimi i lokaleve afariste zejtare ne Rahovec | NRP-02-1004-2023 |

| | | |
|---|---|---|
| 21 | Vendim | NRP-02-1005-2023 |
| 22 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-1007-2023 |
| 23 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për organizimin e festive me karakter bujqësor në Komunën e Rahovec | NRP-02-1008-2023 |
| 24 | Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull:''Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit''. | NRP-02-1009-2023 |
| 25 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërrejtë të menaxherit të kontrates | NRP-02-1013-2023 |
| 26 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-1014-2023 |
| 27 | Vendim-caktohet komisionit per vleresimin e ofertave | NRP-02-1015-2023 |
| 28 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-1016-2023 |
| 29 | Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull:''Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit'' | NRP-02-1020-2023 |
| 30 | Vendim per caktimin e komisionit për vleresimin e ofertave për projektin'' Furnizim me inventarë, pajisje teknologjike, informative për nevojat e QKMF-së'' | NRP-02-1023-2023 |
| 31 | Vendim per caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin' 'Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes së Rahovecit: Dejnë, Krushë e Madhe, Gradish, Drenoc, Rahovec (Zhdrella, të maja e Shkodranit) dhe pastrami I lumit Biqec në Ratkoc | NRP-02-1024-2023 |
| 32 | Vendim per caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin' 'Ndërtimi i shtegut të ecjes dhe turizmit në Rahovec, Drenoc-Polluzhë dhe Xërxë-Opterushë'' | NRP-02-1026-2023 |
| 33 | Vendim për caktimin e komisionit professional për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshëri, erërat e forta dhe vërshimet e shiut më datë 16 deri 30 qershor 2023 | NRP-02-1029-2023 |
| 34 | Vendim per caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-1030-2023 |
| 35 | Vendim per caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-1031-2023 |
| 36 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-1036-2023 |
| 37 | Vendim caktohet komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin' 'Ndërtimi i e-kioskut-Ritenderim''. | NRP-02-1039-2023 |

**Rahovec, korrik 2023**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61, paragrafi 61.15, i Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, të datës 10.4.2019, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i realizimit të kontratës, me titull: "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në komunën e Rahovecit – Faza e parë", me nr. të prokurimit 623-20-2870-5-1-1 dhe numër të brendshëm të prokurimit 623-20-021-5-1-1.
2. Z. Sokol Thaqi, koordinator i projektit (ekipi rajonal për projekte komunale), sipas kontratës së AZHR-së, caktohet menaxher i kontratës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Mbikëqyrës për realizimin e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, caktohet Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit për realizimin e kontratës janë të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L068 dhe Ligjin Nr.05/L-92 dhe në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të datës 10.4.2019.
5. Obligohet menaxheri i kontratës të hartojë Planin e Menaxhimit të Kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja, i cili duhet të nënshkruhet nga Menaxheri i Kontratës së Autoritetit Kontraktues dhe Menaxherit i Kontratës së Operatorit Ekonomik, para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje e nënshkruar e Planit për Menaxhimin e Kontratës do të përcillet te Sektori i Prokurimit.
6. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi për realizimin e kontratës, janë të obliguar që të hartojnë raport me shkrim në baza periodike për kryetarin e Komunës mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.
7. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të punëve të kërkuara, respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Menaxherit të projektit,***
- ***Mbikëqyrësve të kontratës,***
- ***Sektorit të Prokurimit,***
- ***Drejtorisë për Arsim dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 936 Nr. i faq/Br.str/No.pg 190
Data/Datum/Date 3 / 7 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

**Caktohet komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për thirrjen publike: "Praktikant me pagesë në partneritetin publiko – privat"**

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për thirrjen: "Praktikant me pagesë në partneritetin publiko – privat", në këtë përbërje:

    1.1. Fidan Hoti, kryesues,
    1.2. Veton Mustafa, anëtar,
    1.3. Artan Asllani, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve dhe të përpilojë një listë finale të të kualifikuarve për punë praktike, në bazë të thirrjes publike, të shpallur me nr. protokolli: 2189, të datës 15.6.2023.

3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, si dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

***U dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm***
- ***Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe***
- ***Arkivit.***

Sp

Kr

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit
Nr./Br./No 940 Nr. i fq./Br. str./No 190
Data/Datum/Date 4.7.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 941 Nr. i faq/Br.str/No.pg 190
Data/Datum/Date 4/7/23
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] në Rahovec, me Nr. Protokolli 1267, të datës 13.4.2022 për ndihmë financiare prej 700.00€ (shtatëqind euro) për mbulimin [redacted]
2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë financiare të kategorisë së pensionistëve të Komunës së Rahovecit, pasi shumica e kësaj kategorie janë [redacted], është e arsyeshme që kjo kategori e shoqërisë sonë të përkrahet në mënyra të ndryshme.

Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj kategorie të shoqërisë, është e domosdoshme ndihma financiare për participim në blerjen e barnave, participim në rehabilitimin e tyre në qendrat rehabilituese, si dhe në projektet e ndryshme të kësaj organizate, që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të pensionistëve të Komunës së Rahovecit.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- [redacted]
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 942 Nr. i faq/Br.str/No.pg 190
Data/Datum/Date 4 / 7 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2011")*, nenit 8 paragrafi 2 pika 2.2, nenit 9 dhe nenit 12 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, dhe nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e komisionit profesional për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshëri, erërat e forta dhe vërshimet e shiut më datë 1 korrik 2023

1. **Caktohet** komisioni profesional për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshëri, erërat e forta dhe vërshimet e shiut më datë 1 korrik 2023, në territorin e Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:

   **1.1.** Veton Mustafa, kryesues,
   **1.2.** Ilvi Durguti, anëtar,
   **1.3.** Fidan Hoti, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve në bujqësi, të shkaktuara nga breshëri, erërat e forta dhe vërshimet e shiut më datë 1 korrik 2023, në territorin e Komunës së Rahovecit.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe Rregulloren (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 12.7.2023.

5. Obligohet komisioni profesional që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim dhe raportin t'ia dorëzojë Komisionit Komunal për Vlerësimin Dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, i formuar me vendimin Nr. Prot. 02/178, i datës 15.2.2023.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 78 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 9, nenit 10 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 1427, e datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë**

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, në këtë përbërje:
   - 1.1. Antigona Krasniqi, kryesuese,
   - 1.2. Fiknete Kasapi - Iska, anëtare,
   - 1.3. Fjolla Duraku, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të bursave për studentë, sipas dispozitave të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve, Nr. 1427, të datës 28.4.2017.

3. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 1427, të datës 28.4.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kritereve të përcaktuara me Rregullore për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë ka mandat 3 (tre) - vjeçar.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/2245, i datës 9.6.2022.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 8, paragrafi 3, pika 3.2. dhe 3.3. të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt - propozimeve nga projekti ReLOaD2**

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt - propozimeve të OJQ-ve nga projekti ReLOaD2, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit për vitin 2023, në këtë përbërje:
    - 1.1. Qemajl Krasniqi, anëtar,
    - 1.2. Saranda Shala, anëtare,
    - 1.3. Ekrem Bytyqi, anëtar rezervë.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt - propozimeve të OJQ-ve nga projekti ReLOaD2, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, në bazë të thirrjes publike për aplikim dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe thirjen publike për aplikim.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi t'i dërgohet:***

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Znj. Vlora Elshani, Menaxhere e projektit* ***ReLOaD2, dhe***
- ***Arkivit.***

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 965 Nr. i faq/Br.str/No pg. 191
Data/Datum/Date 4.7.23

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MAYOR'S OFFICE
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 950 Nr. i faq/Br.str/No.pg 191
Data/Datum/Date 5/7/23
RAHOVEC / ORAHOVAC


Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/921, e datës 30.6.2023 për qasje në dokumente publike nga Leonora Alija nga OJQ "Iniciativa për Progres - INPO" dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike në aktivitetin e prokurimit me titull "Investime në Zonën Ekonomike në Opterushë – faza e parë", me nr të prokurimit 623-22-8641-5-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/921, e datës 30.6.2023 nga Leonora Alija nga OJQ "Iniciativa për Progres - INPO", për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë: aktivitetin e prokurimit me titull "Investime në Zonën Ekonomike në Opterushë – faza e parë", me nr të prokurimit 623-22-8641-5-2-1.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Leonora Alija nga OJQ "Iniciativa për Progres - INPO", dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 951 Nr. i faq/Br.str/No.pg 191
Data/Datum/Date 5 / 7 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Shtabit komunal për korrje – shirje për vitin 2023**

1. Caktohet Shtabi komunal për korrje – shirje në Komunën e Rahovecit për vitin 2023, në këtë përbërje:

   1.1. Berat Duraku, kryesues i shtabit,
   1.2. Ilvi Durguti, zv. kryesues i shtabit,
   1.3. Hasan Vuqitërna, anëtar,
   1.4. Milazim Elshani, anëtar,
   1.5. Nijazi Sokoli, anëtar.

2. Shtabi komunal ka për detyrë që të bëjë përcjelljen e korrje - shirjeve në terren në të gjithë territorin e Komunës së Rahovecit, gjatë tërë fushatës së korrje – shirjeve, deri në përfundim të saj.

3. Obligohet shtabi komunal që me kohë të njoftojë kryetarin e Komunës dhe personat e tjerë kompetent nga sfera e bujqësisë, si dhe Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me raporte kohë pas kohe, lidhur me rrjedhën e korrje – shirjeve.

4. Shtabi komunal për korrje – shirje do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë me përfundimin e tyre.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Shtabit komunal dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e Shtabit Komunal,***
- ***DBPZHR, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008)*, nenit 8, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e Këshillit Organizues për manifestimet e Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës"

1. **Caktohet** Këshilli Organizues për manifestimet e Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës", në këtë përbërje:

1.1. Fatmir Iska, kryesues,
1.2. Afrim Dina, anëtar,
1.3. Nuri Bugari, anëtar,
1.4. Fjolla Duraku, anëtare,
1.5. Mentor Veliu, anëtar,
1.6. Qemajl Krasniqi, anëtar,
1.7. Muharem Morina, anëtar,
1.8. Feriz Thaqi, anëtar,
1.9. Elmi Popaj, anëtar.

2. Këshilli Organizues ka për detyrë që të ndërrmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbarëvajtjen e manifestimit të Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës".

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të aktiviteteve të manifestimit të Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës", i takon kryesuesit të Këshillit Organizues.

4. Obligohet Këshilli Organizues që të hartojë raport të detajuar për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të aktiviteteve të manifestimit të Ditës së Çlirimit "Epopeja e Rahovecit" dhe "Epopeja e Fortesës".

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjitë anëtarët e Këshillit Organizues.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e Këshillit Oganizues, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 956 Nr. i faq/Br.str/No.pg 192
Data/Datum/Date 6 / 7 / 23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Njësia Nr. Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 962 Nr. i fag/Br.str/No.pg 192
Data Datum Date 6 7 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.0.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/2125, i datës 18.5.2022

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/2125, i datës 18.5.2022, me të cilin znj. Goneta Mustafa, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për shërbime sociale, në Qendrën për Punë Sociale - Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **autorizohet** që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës së Udhëheqësit të sektorit për shërbime sociale, në Qendrën për Punë Sociale - Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe të zgjedhjes së Udhëheqësit të sektorit për shërbime sociale, sipas konkursit.

2. Pas nenit 2 të vendimit bazik, me Nr. Prot. 02/2125. i datës 18.5.2022 shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

   **2A.** Të lartpërmendurës i takon kompensimi i pagës së Udhëheqësit të sektorit për shërbime sociale në Qendrën për Punës Sociale.

3. Ndërsa pikët e tjera të vendimit bazik, me Nr. Prot. 02/2125, i datës 18.5.2022 mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Goneta Mustafa,***
- ***Qendra për Punë Sociale,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008",)* si dhe nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. Me të cilin u lejohet të gjithë mërgimtarëve hyrja pa pagesë në oborrin e komunës me automjete private, që janë me tabela të huaja, si dhe të atyre të marra me qira (rent a car).

2. Hyrja e mërgimtarëve pa pagesë, në oborrin e komunës, me tabela të huaja dhe e atyre të marra me qira (rent a car), lejohet nga data **17 korrik 2023**, deri më datë **18 gusht 2023**.

3. Punonjësve të Administratës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit, u ndalohet hyrja me automjete private në oborrin e komunës, gjatë kësaj periudhe të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Administratë dhe punonjësi i portës.

5. Mosrespektimi i këtij vendimi do të konsiderohet shkelje e kodit të mirësjelljes dhe do të merren masa konform ligjeve, si dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorëve të Drejtorive,***
- ***Punonjësit të portës, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
REPUBLIKA KOSOVO / OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPALITY RAHOVEC
RAHOVEC ORAHOVAC

Hyrja Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 969 Nr. i faq/Br.str/No.pg 193
Data/Datum/Date 7.7.23

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, si dhe nenit 92, të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që, znj. Granita Behra - Zyrtare për Bibloteka, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport ta përfshijë në listën e pagave, me pagë të plotë mujore, nga data 30.6.2023.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Vendimi u dorëzohet:**

*1. Znj. Granita Behra nga Krusha e Madhe,*
*2. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet,*
*3. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,*
*4. Njësisë së Personelit,*
*5. Arkivit.*

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS

Njësia Nr./Br./No 02 Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 970 Nr. i faq/Br.str/No.pg 193
Data/Datum/Date 7.7.23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratave

1. **Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në këtë përbërje:

    **1.1.** Fidan Hoti, kryesues
    **1.2.** Artan Asllani, anëtar
    **1.3.** Jetmir Ukaj, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, respektivisht ecurinë e zbatimit të ofertës së prezantuar, ecurinë e zbatimit të planit dinamik dhe realizimin e kontratës si tërësi.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

4. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në baza periodike, respektivisht çdo 6 (gjashtë) muaj.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Nr./Br./No 974 Nr. i fq/Brstr/No pg 194
Data/Datum/Date 10/7/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së znj. Arjeta Shehu, me Nr. Prot. 2678, të datës 5.7.2023, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për dhënien e pushimit nga puna, pa pagesë**

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e znj. Arjeta Shehu nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për paga dhe mëditje, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, nga data 11.7.2023, deri më datë 30.8.2023.

2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi, i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Obligohet Zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit, që ta largojë nga lista e pagës zyrtaren Arjeta Shehu, për periudhën e lartcekur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Arjeta Shehu, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për paga dhe mëditje, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 2678, të datës 5.7.2023, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë, në kohëzgjatje prej datës 3.7.2023 deri më datë 30.8.2023.

Kërkesën, e lartpërmendura, e ka parashtruar pasi anëtari i familjes është i sëmurë dhe nuk mund të lëvizë dhe për këtë arsye, e lartpërmendura, është e detyruar të kujdeset për të.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës, i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 975 Nr. i fq/Br.str./No. pg. 194
Data/Datum/Date 10 7 23

ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë, për përkujdesjen e shëndetit të nënës së saj dhe të fëmijës.

Andaj, nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Znj. Arjeta Shehu nga Rahoveci,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 984 Nr. i faq/Br.str/No.pg 195
Data/Datum/Date 11/7/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për rivlerësimin e ofertave për projektin: "Zhvendosja e rrjetit dhe e trafos në Sheshin Qendror", me Nr. prokurimi: 623-23-5687-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-043-5-2-1, në këtë përbërje:

   **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues,
   **1.2.** Jeton Krasniqi, anëtar,
   **1.3.** Mimoza Ejupi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë rivlerësimin e ofertave për projektin "Zhvendosja e rrjetit dhe e trafos në Sheshin Qendror", me Nr. prokurimi: 623-23-5687-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-043-5-2-1.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
REPUBLIKA KOSOVO / OPŠTINA ORAHOVAC
REPUBLIC OF KOSOVO / MUNICIPALITY RAHOVEC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 985 Nr. i faq/Br.str/No.pg 195
Data/Datum/Date 11/7/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

**1.** Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës: 623-23-179-5-1-1/C486, si në vijim:

1.1. Z. Sokol Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Koordinator i projektit "Ekipi Rajonal për Projekte Komunale (ERPK)", sipas kontratës së AZHR-së, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

**1.2.** Z. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Shërbime Publike, dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] me Nr. Protokolli 2833, të datës: 11.7.2022 për ndihmë financiare [redacted] (pesëqind euro) [redacted]
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

[redacted], e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare, të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi [redacted] kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për [redacted] kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 991 Nr. i faq Br.str/No.pg 195
Data/Datum/Date 11.7.23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Hekurosja e librave të gjendjes civile", me numër të kontratës 623-23-5603-2-3-6/C487, si në vijim:

   1.1. Z. Petrit Haxhijaha, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar për administrimin e teknologjisë informative, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Administratë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Njësia Nr/Br/No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br. No 1601 Nr. i faq/Br str/No.pg 196
Data/Datum/Date 13 / 7 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Renovime në shkolla", me numër të kontratës 623-23-3431-5-2-1/C488, si në vijim:

   **1.1.** Z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1003 Nr. i faq/Br str/No pg 197
Data/Datum/Date 14 / 7 / 23

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kontratës me titull "Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec", me Nr. të Prokurimit 623-22-12234-5-2-1/C444, Kërkesës së Menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 02/998, të datës 13.7.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

